



Planuar / Dorezuar Prijmljena/Prodato Received/Delivery	24-05	2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SHINGHCK	4401/2023		116	



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.647/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.647/2023 të datës 18.04.2023, të parashtruar nga ankuesi me adrese rruga kundër Vendimit me numër KD.nr.11/2023 të datës 20.03.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike “Masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 24.05.2023, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.647/2023 e datës 18.04.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi me numër KD.nr.11/2023 i datës 20.03.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.
- III. Obligohet Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimin të bëjë zbatimin e këtij vendimit, duke e kthyer ankuesin në vendin e punës sipas kontratës së tij me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e tij e punës dhe të fshijnë nga dosja e ankuesit masën e shqyrtuar.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



## A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar Sipas Kontratës për kohë të pacaktuar të datës 15.07.2020 në pozitën *Zyrtar Korrektues* në Qendrën e Paraburgimit në Prizren në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës, Zëvendësuesi i Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Prizren më datë 01.03.2023 ka parashtruar kërkesë me Nr. 0236/23 për iniciimin e procedurës disiplinore në Komisionin Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me arsyetimin që nuk raporton autoritetet më të larta mbi çdo mall kontrabandë që zbulon tek ndonjë punonjës, i burgosur apo anëtar tjetër të publikut.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës më datë 20.03.2023 ka nxjerr Vendim me numër KD.nr.11/2023 përmes të cilit ankuesin e ka shpall përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore duke i shqiptuar masën disiplinore *"Transferimi në Institucion tjetër Korrektues deri në gjashtë (6) muaj"*.

Ankuesi kundër Vendimit me numër KD.nr.11/2023 të datës 20.03.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, përmes postës më datë 13.04.2023 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 18.04.2023 dhe është regjistruar nën shenjën A.nr.647/2023 me numër protokollit 3624/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 24.04.2023 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës. Ndërsa Këshilli më datë 02.05.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 3624/2023 të datës 18.04.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Shkresë për bastisje e datës 27.02.2023, 01.03.2023; Informatën e datës 04.03.2023, 01.03.2023 e ankuesit; Deklaratën e datës 27.02.2023 nga Vendimin me numër KD.nr.11/2023 të datës 20.03.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Zarin e datës 13.04.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 24.04.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 02.05.2023; Kontratë punë për kohë të pacaktuar e datës 15.07.2020 për ankuesin; Vendimin me Nr. 348 të datës 21.03.2023 për zbatimin e Vendimit me numër KD.nr.11/2023 të datës 20.03.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Fletëkthesën e datës 20.03.2023; Kërkesën me Nr. 0236/23 të datës 01.03.2023 për iniciimin e procedurës disiplinore; Ftesë për intervistë e datës 14.03.2023; Procesverbal i Komisionit Disiplinor i datës 16.03.2023; Komunikimet me telefon; Emailin e datës 01.03.2023 nga për Emailin e datës 28.02.2023, 01.03.2023 nga për ; Informatën me Nr. 268/23 të datës 02.03.2023; Raportin e incidentit i datës 02.02.2023; Shkresë për formën e dorëzimit të



kontrabandës e datës 03.02.2023; Shkresë për bastisje e datës 02.02.2023; Raporti pas bastisjes pozitive i datë 02.02.2023; Fotografi të bastisjes; Emailin e datës 27.02.2023 nga për ; Informatën me Nr. 259/23 e datës 27.02.2023; Fotot e datës 27.02.2023; Shkresë lidhur me inicimin e procedurës disiplinor ndaj ankuesit e datës 03.03.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e bazuar, *sepse*:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër KD.nr.11/2023 të datës 20.03.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, pretendon se një ish i burgosur më datë 27.02.2023 më ka shkruar në Viber për një video që është bërë dhe që po qarkullon në facebook ndërsa telefoni përmes të cilit është bërë kjo video është gjetur me datë 01.03.2023 dhe i njëjti i është dorëzuar policisë, ndërsa në të njëjtën ditë më datë 27.02.2023 është bastisur dhoma e të burgosurit kështu që sipas kësaj logjike i tërë institucioni e ka kuptuar këtë ngjarje mirëpo qëllimi ka qenë që unë të goditem, kështu që vendimi i kontestuar me ankesën është i kundërligjshëm.

Fillimisht Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sipas nenit 4 paragrafit 1 dhe 2, është përcaktuar se: *"1. Nëpunësit profesionalë të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë. 2. Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve",* ndërsa elementet e tjera të marrëdhënies së punës rregullohen me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa sipas Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës konkretisht me nenin 59 paragrafi 1, është përcaktuar se: *"1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj personelit SHKK-së, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga njëzet për qind (20%) deri në katër dhjetë për qind (40%) e pagës për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj; 1.3. transferimi në institucion tjetër korrektues deri në gjashtë (6) muaj; 1.4. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy(2) deri në pesë (5) vjet; 1.5. ulje në pozitë; 1.6. largimi nga shërbimi civil".*

Kolegji i Këshillit, në shqyrtim të provave të lëndës, konstaton se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KD.nr.11/2023 të datës 20.03.2023 për rastin e ankuesit me të cilin i ka shqiptuar masën disiplinore *"Transferimi në institucion tjetër korrektues deri në gjashtë (6) muaj"*, këtë masë e ka shqiptuar duke ju referuar nenit 59 paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, ndërsa kualifikimin e shkëljes e ka bërë mbi bazë të nenit 46 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës.



Duke ju referuar dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili është ligj që rregullon marrëdhënien e punës së zyrtarëve publikë, Kolegji i Këshillit, konstaton se me nenin 4 të këtij ligji janë përcaktuar në mënyrë të qartë se cilat elemente të marrëdhënies së punës së nëpunësve profesional të Shërbimit Korrektues të Kosovës mund të rregullohen me ligj të veçantë, ndërsa çështja e procedurave disiplinore është rregulluar me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht Kolegji i Këshillit, konstaton se procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve të Shërbimit Korrektues të Kosovës rregullohen vetëm me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit konstaton se Vendimi me numër KD.nr.11/2023 i datës 20.03.2023 i Komisionit Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës është i kundërligjshëm në këtë pikëpamje.

Sa i përket pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të dërguara nga palët në procedurë, dhe mbi bazën e vlerësimit të tyre, ka ardhur në përfundim se personi me inicialet në orën 6:30 pasdite i dërgon ankuesit një link në facebook lidhur me një video të bërë nga dhoma D4 e Qendrës së Paraburgimit në Prizren duke i shkruar "a merr masa najkush nket budallen o batjar se na lodhi tu na qu ksi sene", ndërsa ankuesi i kthen "qka po di morë unë". Më datë 27.02.2023 Zëvendësuesi i Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Prizren kë njoftuar që rreth orës 20:00 ka marr një informatë konfidenciale në lidhje me një vizitë të inqizuar dhe të postuar në facebook në emër të dënuarit dhe nga ora 20:10 deri në orën 20:25 kemi realizuar bastisjen mirëpo që ka rezultuar negative.

Marrë për bazë provat e lëndës, i dënuari nga telefoni i të cilit është publikuar videoja më datë 27.02.2023 ka dhënë deklaratë me Nr. 340/22 me anë të së cilës deklaron se videoja është bërë më datë 01.02.2023 me telefonin që është nxan dhe facebookun tim e përdor nipi im, kështu që videoja është e mëhershme dhe sot në bastisje nuk u gjet asgjë, ndërsa ankuesi në informatën e datës 01.03.2023 deklaron se nuk e ka ditur që ka telefon dhe nuk ka mund të i tregoj askujt për këtë për faktin që nuk kam pasur njohuri në lidhje me këtë çështje.

Kolegji i Këshillit, konstaton se më datë 02.02.2023 është bastisur zona D4 në të cilën ka qenë i vendosur i dënuar dhe gjatë bastisjes në bazë të raportit të datës 02.02.2023 është konstatuar se në këtë dhomë është gjetur një telefon Samsung me kartelë të Ipkos, me kabëll mbushës, tri tableta... nja kabllo rreth 4-5 metra, ndërsa në bazë të konstatimit të provave ky telefon i është dorëzuar policisë.

Kolegji i Këshillit, bazuar në të cekurat si më lartë si dhe bazuar në provat e lëndës, konstaton se për rastin kur ankuesi ka marr mesazh në Viber nga personi me inicialet B.S, në dhomën D4 nuk është gjetur asnjë telefon apo gjësend tjetër, m' rast deklarata e të burgosurit përputhet me provat e lëndës, për faktin që këtij personi më datë 02.02.2023 i është gjetur telefoni, si rrjedhojë mund të konstatohet që edhe incizimi ka qenë nga i njëjti telefon, për me tepër provat e lëndës shpien tek konstatimi se ankuesi në kohën kur është njoftuar nga personi me inicialet ,në këtë periudhë kohore ka qenë i njoftuar edhe





Zëvendësuesi i Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Prizren siç e përmend në emailin e datës 27.02.2023 të orës 23:42, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se në këtë kohë përveç ankuesit me rastin kanë qenë të njohur edhe drejtuesit e Qendrës së Paraburgimit në Prizren.

Nisur nga konstatimet si me lartë, Kolegji i Këshillit, vlerëson se iniciimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit është bërë pa u analizuar drejtë gjendja faktike e rastit dhe pa u marr për bazë të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit konkret, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, lidhur me ligjshmërinë e vendimit të kontestuar me ankesë, respektivisht Vendimit me numër KD.nr.11/2023 të datës 20.03.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, konstaton se i njëjti nuk ka marr për bazë provat materiale të lëndës, respektivisht nuk janë konstatuar drejtë elementet e përgjegjësisë disiplinore të përcaktuar me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit”*, ngase me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit nuk janë marr për bazë dispozitat e nenit 50 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit”*, rrjedhimisht në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit ka konstatuar se komisioni disiplinor ka dështuar të vërtetojë faktet nëse ankuesi me veprimet e tij ka shkaktuar ndonjë dëm për institucionin apo palën tjetër, kështu që pretendimet e ankuesit janë të bazuara.

Andaj mbi bazë të këtyre dispozitave ligjore dhe mbi bazë të kësaj gjendje faktike, Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi me numër KD.nr.11/2023 i datës 20.03.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës për shqiptimin e masës disiplinore *“Transferimi në institucion tjetër korrektues deri në gjashtë (6) muaj”*, është në kundërshtim me nenin 45, 47, 48 dhe 50 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, si dhe i njëjti është i paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht Drejtori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës, janë të obliguar që në pajtim me dispozitivin e këtij vendimi të ndërmarrin veprimet e nevojshme ligjore për zbatim të të njëjtit.

Bazuar nga ajo që u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.647/2023, datë 24/05/2023

**Avdyl BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.